



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*



**Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health**  
**Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës**  
**Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova**

## **MORBIDITETI TEK TË MOSHUARIT MBI 65 VJET NË KOSOVË PËR VITET 2022-2023**

**Departamenti i Mjekësisë Sociale/ Divizioni për Moshimin**  
**Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës - IKShPK**  
**Nëntor 2025**

**Botuesi:**

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Copyright:

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Përdorimi i të dhënave lejohet vetëm kur citohet burimi i tyre!

**Dokumenti u hartua nga:**

Dr Pranvera Krasniqi

Prof. asoc. Naim Jerliu

## PARATHËNIE

Raporti "MORBIDITETI TEK TË MOSHUARIT MBI 65 VJET NË KOSOVË PËR VITET 2022-2023" përfshinë të dhënat për sëmundshmërinë (diagnozatat përfundimtare) sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve KNS-10 të regjistruara dhe raportuara nga institucionet e Kujdesit Parësor, Dytësor dhe Tretësor Shëndetësor në Kosovë.

Burim i të dhënave janë institucionet e kujdesit parësor, dytësor dhe tretësor (sektori publik) të Kosovës dhe Departamenti për Statistika Shëndetësore në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës.

Mirënjohje për të gjitha institucionet shëndetësore të Kosovës të cilat ofruan bashkëpunim në mbledhjen e të dhënave.

Besojmë se ky publikim do të shërbejë si informacion dhe motivim për raportim më të suksesshëm, me kohë dhe më cilësor.

Ftojme të gjithë shfrytëzuesit e këtij publikimi për bashkëpunim duke dhënë vërejtje, komente dhe propozime me qëllim të ngritjes së cilësisë së raportimit në funksion të zhvillimit, planifikimit, organizimit dhe menaxhimit të sistemit shëndetësor në Kosovë.

Prof. Dr. Merita Berisha

Dr.Sc Ardita Baraku

*Drejtor i Departamentit për Mjekësi Sociale*

*Drejtor Ekzekutiv i Institutit Kombëtar të  
Shëndetësisë Publike të Kosovës*

## PËRMBAJTJA

|   |    |
|---|----|
| PARATHËNIE .....  | 3  |
| Lista e tabelave .....  | 5  |
| Lista e grafikoneve.....  | 5  |
| Shkurtesat.....   | 6  |
| HYRJE .....   | 7  |
| Të dhëna të përgjithshme për popullatën e moshës 65+ .....                | 7  |
| Morbiditeti në nivel Kosove .....   | 10 |
| Sëmundshmëria e regjistruar në Kujdesin Parësor Shëndetësor (KPSH).....   | 13 |
| Sëmundshmëria e regjistruar në Kujdesin Dytësor Shëndetësor (KDSH).....   | 17 |
| Sëmundshmëria e regjistruar në Kujdesin Tretësor Shëndetësor (KTSH) ..... | 21 |
| PËRFUNDIMET.....  | 25 |
| REKOMANDIMET.....   | 29 |
| Referencat .....  | 30 |

## Lista e tabelave

|   |    |
|---|----|
| Tab. 1. Popullsia rezidente dhe ekonomitë familjare.....  | 7  |
| Tab. 2. Të moshuarit sipas grupmoshës dhe gjinisë, 2024.....  | 8  |
| Tab. 3. Popullsia sipas grupmoshës dhe vitit të regjistrimit.....   | 8  |
| Tab.4. Trendi i numrit të të moshuarve nëpër vite (Projeksion sipas ASK, 2011).....   | 9  |
| Tab.5. Pensionet Bazike të moshës në Kosovë, 2023/2024.....   | 9  |
| Tab.6. Struktura e sëmundjeve sipas grupeve të sëmundjeve për grupmoshën 65+, Kosovë 2022-2023.....                                 | 11 |
| Tab.7. Sëmundjet e regjistruara sipas nivelit të kujdesit shëndetësor tek grupmosha 65+, Kosovë, 2022-2023.....                     | 11 |
| Tab.8. Rastet e sëmundjeve të raportuara në KPSH sipas grupeve të sëmundjeve dhe gjinisë për grupmoshën 65+, Kosovë, 2022-2023..... | 14 |
| Tab.9. Diagnozat më të shpeshta sipas grupit të sëmundjeve në KPSH, 2022-2023.....  | 16 |
| Tab.10. Rastet e sëmundjeve në KDSH sipas grupeve të sëmundjeve dhe gjinisë për grupmoshën 65+, Kosovë, 2022-2023.....              | 18 |
| Tab.11. Diagnozat më të shpeshta sipas grupit të sëmundjeve në KDSH, 2022-2023.....   | 20 |
| Tab.12. Rastet e sëmundjeve në KTSH sipas grupeve të sëmundjeve dhe gjinisë për grupmoshën 65+, Kosovë 2022-2023.....               | 22 |
| Tab.13. Diagnozat më të shpeshta sipas grupit të sëmundjeve në KTSH, 2022-2023.....   | 24 |

## Lista e grafikoneve

|  |    |
|--|----|
| Graf. 1. Struktura e personave mbi 65 vjet sipas gjinisë (%).....                                  | 8  |
| Graf.2. Lëvizja e numrit të të moshuarve nëpër vite në Kosovë .....                                | 9  |
| Graf.3. Morbiditeti sipas nivelit të kujdesit shëndetësor tek grupmosha 65+, Kosovë 2022-2023..... | 12 |
| Graf.4. Struktura e diagnozave më të shpeshta sipas grupit të sëmundjeve në KPSH, 2022-2023.....   | 16 |
| Graf.5. Struktura e diagnozave më të shpeshta në KDSH, 2022-2003.....                              | 20 |
| Graf.6. Struktura e diagnozave më të shpeshta në KTSH, 2022-2023.....                              | 24 |

## Shkurtesat

|          |  |
|----------|--|
| AMF      | Ambulantat ose Punktet shëndetësore                  |
| ASK      | Agjensioni i Statistikave të Kosovës                 |
| COVID-10 | Sëmundja e korona virusit 2019                       |
| DSSH     | Departamenti për Statistika Shëndetësore             |
| IKSHPK   | Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës |
| KNS-X    | Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve, Verzioni 10 |
| KPSH     | Kujdesi parësor shëndetësor                          |
| KDSH     | Kujdesi dytësor shëndetësor                          |
| KTSH     | Kujdesi tretësor shëndetësor                         |
| QKMF     | Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare                |
| QMF      | Qendra e Mjekësisë Familjare                         |

## HYRJE

Ky raport përfshin të dhëna të përgjithshme për popullatën mbi 65 vjet, strukturën sipas gjinisë dhe grupmoshës, pensionet bazike të moshës, si dhe ofron informata lidhur me sëmundshmërinë dhe numrin e vizitave mjekësore, grupet më të shpeshta të sëmundjeve, shpërndarjen e sëmundjeve sipas gjinisë, diagnozat më të shpeshta brenda një grupi të sëmundjeve, dhe niveleve të kujdesit shëndetësor për grupmoshën mbi 65 vjet.

### Të dhëna të përgjithshme për popullatën e moshës 65+

Sipas Agjencionit të Statistikave të Kosovës (ASK) dhe të dhënave nga regjistrimi i popullatës i cili u realizua në vitin 2024 në Kosovë ka gjithsej 1,585,566 banorë, prej të cilëve mbi moshën 65 vjet janë 173,875 ose 10.97%, ndërsa mbi moshën 75 vjet janë 59,163 banorë ose 3.73% e popullsisë së Kosovës (Tab. 1).

Tab. 1. Popullsia rezidente dhe ekonomitë familjare

| Viti i regjistrimit         | 2011       | 2024         |
|-----------------------------|------------|--------------|
| Popullsia e përgjithshme    | 1,739,825  | 1,585,566    |
| Popullsia e moshës 65+      | 116,785    | 173,875      |
| % e popullsisë 65+          | <b>6.7</b> | <b>10.97</b> |
| Popullsia e moshës 75+      | 38,922     | 59,163       |
| % e popullsisë 75+          | <b>2.2</b> | <b>3.73</b>  |
| Mosha mesatare e popullsisë | 28.7       | 34.84        |
| Madhësia e familjes         | 5.9        | 4.33         |

Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës, 2025


Nga i njëjti burim kemi edhe numrin e banorëve të moshës mbi 65 vjet, sipas grupmoshave dhe gjinisë. Nga gjithsej 173,875 banorë të kësaj moshe, të gjinisë femrore janë 91,548 persona ose 52.7 % dhe 82,327 persona ose 47.3 % janë të gjinisë mashkullore (Tab. 2. Graf. 1.).

Tab. 2. Të moshuarit sipas grupmoshës dhe gjinisë, 2024

| Grup moshë      | Gjinia         |               |               |
|-----------------|----------------|---------------|---------------|
|                 | Gjithsejt      | Femra         | Meshkuj       |
| 65-69           | 66,300         | 33,855        | 32,445        |
| 70-74           | 48,412         | 25,410        | 23,002        |
| 75-79           | 31,383         | 16,773        | 14,610        |
| 80-84           | 18,277         | 9,902         | 8,375         |
| 85+             | 9,503          | 5,608         | 3,895         |
| <b>Gjithsej</b> | <b>173,875</b> | <b>91,548</b> | <b>82,327</b> |
| <b>%</b>        | <b>100.0</b>   | <b>52.7</b>   | <b>47.3</b>   |

Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës, 2025

Graf. 1. Struktura e personave mbi 65 vjet sipas gjinisë (%)



Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës, 2025


Numri i personave të moshës 65+ është rritur vazhdimisht. Në vitin 1961 kemi pasur 4.65% të popullsisë të kësaj moshe, në vitin 1971 kemi pasur 4.47%, në vitin 1981 kemi pasur 4.34 %. Rritje më e madhe është regjistruar në vitin 2011 me 6.7 % dhe tani në vitin 2024 me 10.97% (Tab.3., Graf .2.).

Tab. 3. Popullsia sipas grupmoshës dhe vitit të regjistrimit

| Grup moshë      | Viti i regjistrimit |           |           |           |           |
|-----------------|---------------------|-----------|-----------|-----------|-----------|
|                 | 1961                | 1971      | 1981      | 2011      | 2024      |
| <b>65+</b>      | 44,796              | 55,559    | 68,701    | 116,785   | 173,875   |
| <b>Gjithsej</b> | 963,988             | 1,243,693 | 1,584,440 | 1,739,825 | 1,585,566 |
| <b>% 65+</b>    | 4.65                | 4.47      | 4.34      | 6.71      | 10.97     |

Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës, 2025

Graf. 2. Lëvizja e numrit të të moshuarve nëpër vite në Kosovë



Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës, 2025

Sipas projeksionit të ASK-së, deri në vitin 2061 pjesëmarrja e popullatës 65+ pritet të jetë 29%, e cila do të ketë ndikimin e vet edhe në morbiditetin e regjistruar në të gjitha nivelet (Tab.4.).

Tab.4. Trendi i numrit të të moshuarve nëpër vite (Projeksion sipas ASK, 2011)

| Vitet | Popullata sipas moshës |         |           |         | Popullata sipas moshës në % |      |       |      |
|-------|------------------------|---------|-----------|---------|-----------------------------|------|-------|------|
|       | Total                  | 0-14    | 15-64     | 65+     | Total                       | 0-14 | 15-64 | 65+  |
| 2011  | 1,780,021              | 495,101 | 1,162,044 | 122,876 | 100                         | 27.8 | 65.3  | 6.9  |
| 2021  | 1,883,805              | 406,059 | 1,301,556 | 176,190 | 100                         | 21.6 | 69.1  | 9.4  |
| 2031  | 1,931,957              | 371,065 | 1,308,534 | 252,358 | 100                         | 19.2 | 67.7  | 13.1 |
| 2041  | 1,923,175              | 313,466 | 1,262,015 | 347,693 | 100                         | 16.3 | 65.6  | 18.1 |
| 2051  | 1,859,447              | 256,760 | 1,177,814 | 424,872 | 100                         | 13.8 | 63.3  | 22.8 |
| 2061  | 1,743,470              | 215,907 | 1,022,265 | 505,299 | 100                         | 12.4 | 58.6  | 29.0 |

Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës, 2011

Sipas Raportit të statistikave të mirëqenies sociale në Kosovë për vitet 2023 dhe 2024, në muajin korrik 2023, numri i përfituesve nga skema e pensioneve bazike të moshës ishte 148,802 persona, ndërsa në muajin korrik 2024, numri i përfituesve nga skema e pensioneve bazike të moshës ishte 150,790 persona.

Tab.5. Pensionet bazike të moshës në Kosovë, 2023/2024

| Pensionet        | Korrik 2023 | Korrik 2024 |
|------------------|-------------|-------------|
| Bazike të moshës | 148,802     | 150,790     |

Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës. Statistikat e mirëqenies sociale në Kosovë për vitet 2023/2024

## Morbiditeti në nivel Kosove

Morbiditeti si indikator negativ i gjendjes shëndetësore të popullatës është me interes të madh, sepse është treguesi më i mirë i gjendjes shëndetësore të popullatës.

Kjo analizë ofron informata lidhur me sëmundshmërinë dhe numrin e vizitave mjekësore, grupet më të shpeshta të sëmundjeve, shpërndarjen e sëmundjeve sipas gjinisë, diagnozat më të shpeshta brenda një grupi të sëmundjeve, dhe niveleve të kujdesit shëndetësor për grupmoshën mbi 65 vjet.

Në këtë dokument morbiditeti është analizuar sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve, Verzioni 10 (KNS-X), i cili përmban 21 grupe të sëmundjeve. Për përpilimin e analizës së morbiditetit janë përdorur të dhënat nga Departamenti për Statistika Shëndetësore-DSSH në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK), diagnozat e agreguara sipas grupeve të sëmundjeve dhe gjinisë për të tre nivelet e kujdesit shëndetësor për grupmoshën mbi 65 vjet.

Sipas të dhënave të IKSHPK-së për morbiditetin e të moshuarve mbi 65 vjet në nivel vendi përqindja më e madhe e diagnozave është regjistruar në grupin XXI *Faktorët që ndikojnë në gjendjen shëndetësore dhe kontakti me shërbim shëndetësor* me gjithsej 23.3 % në vitin 2022 dhe 23 % në vitin 2023.

Pasojnë grupi IX i sëmundjeve që i përkasin *Sëmundjeve të sistemit të qarkullimit të gjakut* me 18.7 % në vitin 2022 dhe 17.3% në vitin 2023, grupi X *Sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes* me gjithsej 12.8 % të rasteve në vitin 2022 dhe 14.2 % në vitin 2023, si dhe grupi IV *Çrregullimet endokrine, të ushqyeshmërisë dhe metabolizmit* me gjithsej 11 % të rasteve për vitin 2022 dhe me 11.2 % të rasteve në vitin 2023, ndërsa grupet tjera të sëmundjeve me më pak se 10 %. Të dhënat e sakta të strukturës së sëmundjeve të raportuara sipas grupeve të sëmundjeve janë të dhëna në tabelën në vijim (Tab.6).

Indeksi bazë na tregon se në vitin 2023 kemi rritje të numrit të rasteve të raportuara në shumicën e grupeve të sëmundjeve në krahasim me vitin 2022, ku rritja më e madhe është në grupin XVIII *Simptomat, shenjat, analizat dhe konstatimet abnormale klinike dhe laboratorike të paklasifikuara gjetiu* me 59.8% kurse më së shumti rënie të numrit të rasteve kemi tek COVID-19 me 78.3 % krahasuar me vitin bazë 2022 (Tab.6).

Në Tab. 7 dhe Graf. 3 shihet se 90.7 % të rasteve për vitin 2022 dhe 93.3% në vitin 2023 të sëmundjeve janë regjistruar në nivelin parësor shëndetësor, 6.3 % në 2022 dhe 4.4 % në 2023 në nivelin dytësor shëndetësor dhe 2.9 % në vitin 2022 dhe 2.3 % në vitin 2023 në atë tretësor shëndetësor. Të dhënat tregojnë për një trend në rritje të raportimeve të rasteve në kujdesin parësor dhe në rënie për kujdesin dytësor, përkatësisht tretësor.

Tab.6. Struktura e sëmundjeve sipas grupeve të sëmundjeve për grupmoshën 65+, Kosovë 2022-2023

| Grupet e sëmundjeve  | Viti 2022      |              | Viti 2023      |              | Indeksi bazë (%) |
|--|----------------|--------------|----------------|--------------|------------------|
|  | N              | %            | N              | %            |                  |
| Gr I.Sëmundjet infektive dhe parazitare (A00-B99)  | 7,997          | 1.6          | 10,272         | 1.6          | 128.4            |
| <b>COVID 19 (U07.1)</b>  | 1,027          | 0.2          | 223            | 0.0          | 21.7             |
| Gr II. Tumorët (C00-D48)   | 5,951          | 1.2          | 6,968          | 1.1          | 117.1            |
| Gr III. Sëmundjet e gjakut dhe organeve hemopoetike dhe çrregullimet e imunitetit(D50-D89)                         | 8,240          | 1.7          | 8,468          | 1.3          | 102.8            |
| Gr IV.Çrregullimet Endokrine, të ushqyeshmërisë dhe metabolizmit (E00-E90)   | 53,947         | 11.0         | 73,742         | 11.2         | 136.7            |
| Gr V.Çrregullimet psikike dhe të personalitetit (F00-F99)  | 4,515          | 0.9          | 6,262          | 1.0          | 138.7            |
| Gr VI. Sëmundjet SNQ (G00-G99)   | 5,207          | 1.1          | 6,176          | 0.9          | 118.6            |
| Gr VII. Sëmundjet e syrit (H00-H59)  | 6,282          | 1.3          | 9,404          | 1.4          | 149.7            |
| Gr VIII. Sëmundjet e veshit dhe procesit mastoid (H60-H95)   | 3,855          | 0.8          | 4,823          | 0.7          | 125.1            |
| Gr IX. Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut (I00-I99)   | 91,951         | 18.7         | 113,543        | 17.3         | 123.5            |
| Gr X. Sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes (J00-J99)   | 62,867         | 12.8         | 93,658         | 14.2         | 149.0            |
| Gr XI. Sëmundjet e sistemit të tretjes (K00-K93)   | 22,135         | 4.5          | 29,970         | 4.6          | 135.4            |
| Gr XII. Sëmundjet e lëkures dhe indit nënëkuror (L00-L99)  | 7,626          | 1.5          | 8,253          | 1.3          | 108.2            |
| Gr XIII.Sëmundjet e sistemit lokomotor dhe indit lidhor (M00-M99))   | 39,232         | 8.0          | 56,455         | 8.6          | 143.9            |
| Gr XIV. Sëmundjet e sistemit urogenital ((N00-N99  | 23,713         | 4.8          | 27,439         | 4.2          | 115.7            |
| Gr XV.Shtatzënia, lindja dhe lehonja (O00-O99)   | 0              | 0.0          | 0              | 0.0          | 0.0              |
| Gr XVI. Gjendjet e caktuara që rrjedhin nga periudha perinatale (P00-P96)  | 2              | 0.0          | 0              | 0.0          | 0.0              |
| Gr XVII. Komplikimet e lindura, deformimet dhe anomalitë kromozomale (Q00-Q99)                                     | 111            | 0.0          | 75             | 0.0          | 67.6             |
| Gr XVIII.Simptomët, shenjat, analizat dhe konstatimet abnormale klinike dhe lab.të paklasifikuara gjetiu (R00-R99) | 25,956         | 5.3          | 41,368         | 6.3          | 159.4            |
| Gr XIX. Lëndimet, helmimet dhe disa nga pasojat tjera të shkaktuara nga faktorët e jashtëm(S00-T98)                | 6,928          | 1.4          | 9,287          | 1.4          | 134.1            |
| Gr XX.Shkaktarët e jashtëm të morbiditetit dhe mortalitetit (V01-Y98)  | 83             | 0.0          | 102            | 0.0          | 122.9            |
| Gr XXI. Faktorët që ndikojnë në gjendjen shëndetësore dhe kontakti me shërbim shëndetësor (Z00-Z99)                | 114,547        | 23.3         | 151,067        | 23.0         | 131.9            |
| Panjohur   | 19             | 0.0          | 122            | 0.0          | 642.1            |
| <b>Totali</b>  | <b>492,191</b> | <b>100.0</b> | <b>657,681</b> | <b>100.0</b> | <b>133.6</b>     |

Burimi: IKSHPK, Raporti i morbiditetit në Kosovë, 2022-2023


Indeksi bazë na tregon se në vitin 2023 krahasuar me vitin bazë 2022 ka pasur rritje të raportimit të morbiditetit në Kujdesin parësor shëndetësor (KPSH) për 37.39%, në Kujdesin tretësor shëndetësor (KTSH) rritja ka qenë 3.77% kurse në Kujdesin dytësor shëndetësor (KDSH) kemi rënie të raportimit të morbiditetit për 6.43% krahasuar me vitin bazë 2022. Në vitin 2023 në total kemi rritje të numrit të rasteve të raportuara të morbiditetit për 33.6% krahasuar me vitin 2022 ( Tab.7.).

Tab.7. Sëmundjet e regjistruara sipas nivelit të kujdesit shëndetësor tek grupmosha 65+, Kosovë 2022-2023

| Niveli i kujdesit | Sëmundjet e regjistruara |            |                |            | Indeksi bazë (2023/2022) (%) |
|-------------------|--------------------------|------------|----------------|------------|------------------------------|
|                   | Viti 2022                |            | Viti 2023      |            |                              |
|                   | N                        | %          | N              | %          |                              |
| Shendetesor       |                          |            |                |            |                              |
| KPSH              | 446,520                  | 90.7       | 613,467        | 93.3       | 137.39                       |
| KDSH              | 31,153                   | 6.3        | 29,149         | 4.4        | 93.57                        |
| KTSH              | 14,518                   | 2.9        | 15,065         | 2.3        | 103.77                       |
| <b>Totali</b>     | <b>492,191</b>           | <b>100</b> | <b>657,681</b> | <b>100</b> | <b>133.62</b>                |

Burimi: IKSHPK Raporti i morbiditetit në Kosovë, 2022-2023

Graf.3. Morbiditeti sipas nivelit të kujdesit shëndetësor tek grupmosha 65+, Kosovë 2022-2023



Burimi: IKSHPK, Raporti i morbiditetit në Kosovë, 2022-2023

## Sëmundshmëria e regjistruar në Kujdesin Parësor Shëndetësor (KPSH)

Kujdesi parësor shëndetësor me të gjitha Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulantat ose Punktet shëndetësore (AMF) në gjithë territorin e Republikës së Kosovës ofron shërbime shëndetësore për qytetarët dhe njehërit raporton për punën e vet në IKSHPK.

Sipas morbiditetit të raportuar nga KPSH në nivel Kosove më së shumti raste të sëmundjeve kemi në grupin XXI, *Faktorët që ndikojnë në gjendjen shëndetësore dhe kontakti me shërbim shëndetësor* me 25.3 % të rasteve në 2022 dhe 24.3 % në vitin 2023, pastaj në grupin IX *Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut* me 17.5 % të rasteve në 2022 dhe 16.3 % në vitin 2023, në grupin X *Sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes* me 13.2 % të rasteve në 2022 dhe 14.7 % në vitin 2023, në grupin IV *Çrregullimet endokrine, të ushqyeshmërisë dhe metabolizmit* me 11.4 % të rasteve në 2022 dhe 11.6 % në 2023 ndërsa grupet tjera të sëmundjeve me më pak se 10 % (Tab. 8.).

Indeksi bazë na tregon se në vitin 2023 kemi rritje të numrit të rasteve të raportuara në të gjitha grupet e sëmundjeve përveç rasteve në grupin XVII *Komplikimet e lindura, deformimet dhe anomalitë kromozomale* ku kemi rënie për 47.1 % krahasuar me vitin bazë 2022.

Në vitin 2023 në total kemi rritje të numrit të rasteve të sëmundjeve të raportuara për 37.4% krahasuar me vitin bazë 2022 (Tab. 8.).

Tab.8. Rastet e sëmundjeve të raportuara në KPSH sipas grupeve të sëmundjeve dhe gjinisë për grupmoshën 65+, Kosovë, 2022-2023

| Grupet e sëmundjeve   | Viti 2022 |         |         |         | Viti 2023 |         |         |         | Indeksi bazë (%) |       |
|---|-----------|---------|---------|---------|-----------|---------|---------|---------|------------------|-------|
|   | Gjinia    |         | 65+     |         | Gjinia    |         | 65+     |         |                  |       |
|   | F         | M       | N       | %       | F         | M       | N       | %       |                  |       |
| Gr I.Sëmundjet infektive dhe parazitare (A00-B99)   | 3,814     | 3,409   | 7,223   | 1.6     | 5,119     | 4,344   | 9,463   | 1.5     | 131.0            |       |
| Gr II. Tumorët (C00-D48)  | 1,960     | 1,859   | 3,819   | 0.9     | 2,551     | 2,106   | 4,657   | 0.8     | 121.9            |       |
| Gr III. Sëmundjet e gjakut dhe organeve hemopoetike dhe çrregullimet e imunitetit(D50-D89)                        | 1,631     | 1,137   | 2,768   | 0.6     | 1,917     | 1,284   | 3,201   | 0.5     | 115.6            |       |
| Gr IV.Çrregullimet Endokrine, të ushqyeshmërisë dhe metabolizmit (E00-E90)  | 27,395    | 23,691  | 51,086  | 11.4    | 38,521    | 32,618  | 71,139  | 11.6    | 139.3            |       |
| Gr V.Çrregullimet psikike dhe të personalitetit (F00-F99)   | 2,348     | 1,988   | 4,336   | 1.0     | 3,217     | 2,912   | 6,129   | 1.0     | 141.4            |       |
| Gr VI. Sëmundjet SNQ (G00-G99)  | 2,740     | 2,135   | 4,875   | 1.1     | 3,146     | 2,636   | 5,782   | 0.9     | 118.6            |       |
| Gr VII. Sëmundjet e syrit (H00-H59)   | 2,440     | 2,598   | 5,038   | 1.1     | 3,924     | 4,042   | 7,966   | 1.3     | 158.1            |       |
| Gr VIII. Sëmundjet e veshit dhe procesit mastoid (H60-H95)  | 1,855     | 1,931   | 3,786   | 0.8     | 2,351     | 2,381   | 4,732   | 0.8     | 125.0            |       |
| Gr IX. Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut (I00-I99)  | 39,690    | 38,655  | 78,345  | 17.5    | 51,306    | 48,915  | 100,221 | 16.3    | 127.9            |       |
| Gr X. Sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes (J00-J99)  | 31,084    | 28,010  | 59,094  | 13.2    | 46,407    | 43,764  | 90,171  | 14.7    | 152.6            |       |
| Gr XI. Sëmundjet e sistemit të tretjes (K00-K93)  | 10,242    | 9,005   | 19,247  | 4.3     | 13,928    | 12,978  | 26,906  | 4.4     | 139.8            |       |
| Gr XII. Sëmundjet e lëkures dhe indit nënëkuror (L00-L99)   | 3,824     | 3,573   | 7,397   | 1.7     | 4,146     | 3,889   | 8,035   | 1.3     | 108.6            |       |
| Gr XIII.Sëmundjet e sistemit lokomotor dhe indit lidhor (M00-M99))  | 20,787    | 17,668  | 38,455  | 8.6     | 28,998    | 26,548  | 55,546  | 9.1     | 144.4            |       |
| Gr XIV. Sëmundjet e sistemit urogenital ((N00-N99   | 9,129     | 8,353   | 17,482  | 3.9     | 10,422    | 11,012  | 21,434  | 3.5     | 122.6            |       |
| Gr XV.Shtatzënia, lindja dhe lehonja (O00-O99)  | 0         | 0       | 0       | 0.0     | 0         | 0       | 0       | 0.0     | 0.0              |       |
| Gr XVI. Gjendjet e caktuara që rrjedhin nga periudha perinatale (P00-P96)   | 0         | 0       | 0       | 0.0     | 0         | 0       | 0       | 0.0     | 0.0              |       |
| Gr XVII. Komplikimet e lindura, deformimet dhe anomalitë kromozomale (Q00-Q99)                                    | 41        | 27      | 68      | 0.0     | 15        | 21      | 36      | 0.0     | 52.9             |       |
| Gr XVIII.Simptomt, shenjat, analizat dhe konstatimet abnormale klinike dhe lab.të paklasifikuara gjetiu (R00-R99) | 13,687    | 11,406  | 25,093  | 5.6     | 21,454    | 19,072  | 40,526  | 6.6     | 161.5            |       |
| Gr XIX. Lëndimet, helmimet dhe disa nga pasojat tjera të shkaktuara nga faktorët e jashtëm(S00-T98)               | 3,028     | 2,628   | 5,656   | 1.3     | 4,510     | 3,801   | 8,311   | 1.4     | 146.9            |       |
| Gr XX.Shkaktarët e jashtëm të morbiditetit dhe mortalitetit (V01-Y98)   | 0         | 0       | 0       | 0.0     | 0         | 0       | 0       | 0.0     | 0.0              |       |
| Gr XXI. Faktorët që ndikojnë në gjendjen shëndetësore dhe kontakti me shërbim shëndetësor (Z00-Z99)               | 57,783    | 54,969  | 112,752 | 25.3    | 75,582    | 73,626  | 149,208 | 24.3    | 132.3            |       |
| Totali  | N         | 233,478 | 213,042 | 446,520 | 100       | 317,517 | 295,950 | 613,467 | 100              | 137.4 |
|   | %         | 52.3    | 47.7    | 100     | 51.8      | 48.2    | 100     |         |                  |       |

Burimi: IKSHPK, Morbiditeti KPSH, Janar-Dhjetor 2022-2023

Sa i përket diagnozave më të shpeshta sipas grupit të sëmundjeve, në KPSH, për vitin 2022 dhe 2023 e që janë paraqitur në Tab. 9 dhe Graf. 4 janë këto diagnoza të agreguara: në grupin I *Sëmundjet infektive dhe parazitare* diagnoza A 09 është diagnoza më e raportuar për të dy vitet e analizuara.

Në grupin II *Tumorët* më së shumti raste janë raportuar si diagnoza C 50 për të dy vitet e raportuara.

Në grupin III *Sëmundjet e gjakut dhe organeve hemopoetike dhe çrregullimit të imunitetit* diagnozat D 50 paraqet numrin më të madh të rastve për të dy vitet e raportuara.

Në grupin IV *Çrregullimet endokrine, të ushqyeshmërisë dhe metabolizmit*, diagnozat e agreguara E 10-14 janë më të shpeshta në dy vitet e raportuara.

Në grupin V të *Sëmundjeve psikike dhe të personalitetit* më së shumti raste janë raportuar si diagnoza F 40-48 në këto dy vite.

Në grupin VI *Sëmundjet e SNQ*, më së shumti raste të raportuara për të dy vitet e analizuara i përkasin diagnozave G 43-44.

Në grupin VII *Sëmundjet e syrit* diagnozat H 10-13 janë diagnozat e agreguara më të raportuara për të dy vitet e analizuara.

Në grupin e VIII, *Sëmundjet e veshit dhe procesit mastoid*, diagnozat H 65-65 janë më të raportuarat për këto dy vitet e analizuara.

Në grupin IX, *Sëmundjet e qarkullimit të gjakut*, diagnoza I 10 është më e shpeshta për të dy vitet e analizuara.

Në grupin X *Sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes* diagnoza me e shpeshtë është J 02-02.9 për të dy vitet e analizuara.

Në grupin XI, *Sëmundjet e sistemit të tretjes* diagnoza me më së shumti raste të raportuara është K29 për këto dy vite të raportuara.

Në grupin XIII, *Sëmundjet e sistemit lokomotor dhe indit lidhor*, diagnoza më e raportuar është M 40-49-53-84 për dy vitet e analizuara.

Në grupin XIV, *Sëmundjet e sistemit urogjenital*, më së shpeshti është raportuar diagnoza N 25-29-31-39 për dy vitet e analizuara.

Në grupin XVIII, *Simptomat, shenjat, analizat dhe konstatimet abnormale klinike dhe laboratorike të paklasifikuara gjetiu* më së shpeshti është raportuar diagnoza R 10 për këto dy vite të analizuara.

Në grupin XIX, *Lëndimet, helmimet dhe disa nga pasoja të tjera të shkaktuara nga faktorët e jashtëm* ka më së shumti raste të raportuara si diagnoza S 00-04-11-14-16-19-21-24-25-29-31-34-35-39-41-44-46-49-51-54-56-59-61-64-66-69-71-74-76-79-81-84-86-89-91-94-96-99-T00-01-06-07-09-11-13-14 për këto dy vite të analizuara.

Në grupin XXI, *Faktorët që ndikojnë në gjendjen shëndetësore dhe kontakti me shërbim shëndetësor* diagnozat Z 00-13 janë më të raportuarat për të dy vitet e analizuara.


Tab.9. Diagnozatat më të shpeshta sipas grupit të sëmundjeve në KPSH, 2022-2023

| Diagnozat më të shpeshta në secilin grup të sëmundjeve | Viti 2022 |        | Viti 2023 |        |
|--|-----------|--------|-----------|--------|
|  | F         | M      | F         | M      |
| A09  | 2,987     | 2,552  | 3,923     | 3,430  |
| C50  | 609       | 0      | 842       | 0      |
| D50  | 1,425     | 955    | 1,527     | 1,012  |
| E10-14   | 23,729    | 21,327 | 24,429    | 21,696 |
| F40-48   | 773       | 633    | 738       | 644    |
| G43-44   | 1,934     | 1,420  | 1,720     | 1,361  |
| H10-13   | 1,263     | 1,364  | 1,527     | 1,533  |
| H65-75   | 812       | 747    | 1,016     | 1,056  |
| I10  | 34,028    | 33,337 | 31,066    | 29,241 |
| J02-J02.9  | 8,252     | 7,379  | 15,045    | 14,250 |
| K29  | 5,697     | 4,768  | 5,859     | 5,267  |
| L10-L99  | 2,401     | 2,218  | 2,130     | 2,154  |
| M 40-49-53-84  | 11,467    | 10,021 | 12,063    | 10,283 |
| N25-29-31-39   | 2,648     | 2,127  | 2,348     | 1,930  |
| R10  | 2,612     | 2,041  | 4,139     | 3,661  |
| Disa diagnoza tjera të agreguara*                      | 1,425     | 1,201  | 1,734     | 1,594  |
| Z00-Z13  | 19,682    | 19,129 | 25,890    | 25,972 |

Burimi: IKSHPK, Morbiditeti KPSH, Janar-Dhjetor 2022-2023

\* S00-04-09-11-14-16-19-21-24-25-29-31-34-35-39-41-44-46-49-51-54-56-59-61-64-66-69-71-74-76-79-81-84-86-89-91-94-96-99-T00-01-06-07-09-11-13-14

Graf.4. Struktura e diagnozave më të shpeshta sipas grupit të sëmundjeve në KPSH, 2022-2023



Burimi: IKSHPK, Morbiditeti KPSH, Janar-Dhjetor 2022-2023

\* S00-04-09-11-14-16-19-21-24-25-29-31-34-35-39-41-44-46-49-51-54-56-59-61-64-66-69-71-74-76-79-81-84-86-89-91-94-96-99-T00-01-06-07-09-11-13-14

## Sëmundshmëria e regjistruar në Kujdesin Dytësor Shëndetësor (KDSH)

Sa i përket sëmundshmërisë të regjistruar në KDSH në vitin 2022 më së shumti raste i takojnë grupit IX, *Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut* me 33.7 % të rasteve, grupit XIV, *Sëmundjet e sistemit urogjenital* dhe grupit III, *Sëmundjet e sistemit të gjakut dhe organet hemopoetike dhe çrregullimet e imunitetit* me përqindje të njëjtë 16.4% të rasteve, pasojnë grupi X, *Sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes* me 7.6 % të rasteve, grupi IV, *Çrregullimet endokrine, të ushqyeshmërisë dhe metabolizmit* me 5.1% grupi XI, *Sëmundjet e sistemit të tretjes* me 5.3% të rasteve, ndërsa grupet tjera të sëmundjeve janë të përfaqësuara me më pak se 5 %, (Tab.10).

Në vitin 2023 më së shumti raste i takojnë grupit IX, *Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut* me 34.1 % të rasteve, grupi III, *Sëmundjet e sistemit të gjakut dhe organet hemopoetike dhe çrregullimet e imunitetit* me 16.8% të rasteve, grupit XIV, *Sëmundjet e sistemit urogjenital* dhe grupime me 16.5% të rasteve, grupit X, *Sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes* me 7.2 % të rasteve, grupit XI, *Sëmundjet e sistemit të tretjes* me 5.6% të rasteve, grupit IV, *Çrregullimet endokrine, të ushqyeshmërisë dhe metabolizmit* me 4.8 %, ndërsa grupet tjera të sëmundjeve janë të përfaqësuara me më pak se 4.5 %, (Tab.10.).

Indeksi bazë na tregon se në vitin 2023 në total kemi rënie të numrit të rasteve të sëmundjeve të raportuara për 6.4% krahasuar me vitin bazë 2022, edhe pse disa grupe të sëmundjeve kanë pasur rritje të numrit të raportimeve e disa të tjera rënie (Tab.10.).

Tab.10. Rastet e sëmundjeve në KDSH sipas grupeve të sëmundjeve dhe gjinisë për grupmoshën 65+, Kosovë, 2022-2023

| Grupet e sëmundjeve  | Viti 2022 |        |        |        | Viti 2023 |        |        |        | Indeksi bazë (%) |      |
|--|-----------|--------|--------|--------|-----------|--------|--------|--------|------------------|------|
